

V E N D I M
Nr. 551, datë 7.11.2002

**PËR KLASIFIKIMIN E FUNKSIONEVE DHE GRUPIMIN E NJËSIVE TË QEVERISJES
VENDORE, PËR EFEKT PAGE, E PËR CAKTIMIN E KUFIJVE TË PAGAVE TË
PUNONJËSVE TË ORGANEVE TË QEVERISJES VENDORE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 5 të ligjit nr. 8487, datë 13.5.1999 “Për kompetencat e caktimit të pagave të punës”, ndryshuar me ligjin nr. 8935, datë 12.9.2002 dhe të neneve 32 e 54 të ligjit nr. 8652, datë 31.7.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, me propozimin e Ministrit të Punës dhe Çështjeve Sociale dhe të Ministrit të Pushtetit Vendor dhe të Decentralizimit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Struktura e pagave dhe nivelet për nëpunësit civilë në Bashkinë e Tiranës të jenë sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Struktura e pagave dhe nivelet për nëpunësit civilë në bashkitë e tjera, njësitë bashkiake të Tiranës dhe për nëpunësit e komunave sipas lidhjes nr.2, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

3. Struktura dhe nivelet e pagave për nëpunësit civilë në këshillin e qarkut të jenë sipas lidhjes nr.3, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

4. Paga e grupit, (kolona 2) - diploma e shkollës së lartë të jetë 9000 lekë.

5. Shtesa për vjetërsi në punë (kolona 3) të jepet në masën 2 për qind pas çdo viti pune, deri në 25 vjet, dhe të llogaritet mbi pagën e grupit.

6. Shtesa për kualifikim (kolona 4) të jetë 0.

7. Shtesa për pozicion për Bashkinë e Tiranës dhe këshillin e qarkut të jetë sipas kolonës 5, ndërsa për bashkitë e tjera, komunat dhe njësitë bashkiake të Tiranës të jetë sipas kolonave 5, 6, 7 e 8 të lidhjeve nr.1, 2 dhe 3.

8. Kategorizimi (kolona 1) brenda çdo klase bëhet në përputhje me lidhjen nr. 4, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

9. Nivelet e pagave për funksionet e mëposhtme të jenë:

a) Për Bashkinë e Tiranës:

- Kryetari 104 500 -150 000 lekë;

- Nënkyetari 69 500 – 117 000 lekë.

b) Për njësitë e qeverisjes vendore, me më tepër se 50 000 banorë:

- kryetari 49 660 -100 000 lekë;

- nënkryetari 21 000 – 75 000 lekë.

c) Për njësitë e qeverisjes vendore, me 20 001 - 50 000 banorë:

- kryetari 33 980 -80 000 lekë;

- nënkryetari 20 000 – 65 000 lekë.

ç) Për njësitë e qeverisjes vendore, me 5 001 - 20 000 banorë:

- kryetari 21 000 –65 000 lekë;

- nënkryetari 17 000 – 55 000 lekë.

Për njësitë e qeverisjes vendore, me më pak se 5 000 banorë:

- kryetari 17 000 - 40 000 lekë;

- nënkryetari 16 000 – 30 000 lekë.

dh) Për këshillin e qarkut:

- kryetari 69 500 -110 000 lekë;

- nënkryetari 40 500 – 75 000 lekë.

Për funksionin e sekretarit:

- Sekretari i Kryetarit të Bashkisë së Tiranës Kategoria IV-a (lidhja nr.1);

- sekretari i kryetarit të bashkive të tjera Kategoria IV-b (lidhja nr.2);

- Sekretari i Kryetarit të Këshillit të Qarkut të Tiranës Kategoria IV-b (lidhja nr.3);

10. Nivelet e pagave për funksionet e mëposhtme të jenë:

- Shefi i Kabinetit në Bashkinë e Tiranës dhe Sekretari i Këshillit Bashkiak të Tiranës:

kategoria II-a (lidhja nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi);

- Këshilltari i Kryetarit të Bashkisë së Tiranës dhe zëdhënësi: kategoria II-b (lidhja nr. 1 që i bashkëlidhet këtij vendimi);

- Shefi i Kabinetit dhe Sekretari i Këshillit të Qarkut: kategoria I-b (lidhja nr.3 që i bashkëlidhet këtij vendimi).

- Këshilltari i Kryetarit të Këshillit të Qarkut dhe zëdhënësi: kategoria II-b (lidhja nr.3 që i bashkëlidhet këtij vendimi).

- Shefi i kabinetit dhe sekretari i këshillit bashkiak të bashkive të tjera, të njësive bashkiake të Tiranës dhe të komunave: kategoria I-b (lidhja nr. 2 që i bashkëlidhet këtij vendimi).

- Këshilltari i kryetarit të bashkisë dhe zëdhënësi i bashkive të tjera, i njësive bashkiake të Tiranës dhe i komunave: kategoria II-b (lidhja nr.2 që i bashkëlidhet këtij vendimi).

11. Këshilli i qarkut, këshilli bashkiak, këshilli i komunës miratojnë pagën për secilin funksion, të zgjedhur apo të emëruar, brenda kufijve të pagave të përcaktuara, përkatësisht në lidhjet nr.1, 2 e 3, që i bashkëlidhen këtij vendimi, si dhe në pikën 10 të këtij vendimi. Këshilli Bashkiak i Tiranës miraton pagën për funksionet, e zgjedhura apo të emëruara, të njësive bashkiake të Tiranës. Për caktimin e pagës, këshillat përkatëse mbështeten në burimet financiare të buxhetit të tyre vjetor.

Për këtë ata bëjnë rritje graduale të pagës në raport me rritjen e burimeve të brendshme financiare dhe përmirësimin e strukturës së administratës, por pa prekur nivelin e shpenzimeve për shërbimet publike të vitit pararendës.

12. Këshillat e njësive të qeverisjes vendore, kur është e nevojshme, krijojnë funksione të reja, të cilat nuk janë të përcaktuara në lidhjet, që i bashkëlidhen këtij vendimi, bëjnë njehsimin e tyre, për efekt page, me klasifikimin e miratuar.

13. Këshillat e njësive të qeverisjes vendore miratojnë shpërblimin mujor të këshilltarëve dhe kryetarëve të fshatrave në masën deri në 10 për qind të pagës, përkatësisht, të kryetarit të këshillit të qarkut, kryetarit të bashkisë, kryetarit të njësisë bashkiake dhe atij të komunës.

14. Këshillat e njësive të qeverisjes vendore miratojnë pagën e punonjësve të njësive ekonomike dhe të institucioneve të varësisë, me përjashtim të rasteve kur me ligj është parashikuar ndryshe.

15. Paga e punonjësve që kanë funksione në shërbimin civil, por që nuk kanë arsimin e lartë, caktohet nga këshilli përkatës në kufirin maksimal deri në 25 000 (njëzet e pesë mijë) lekë.

16. Paga e punonjësve të tjerë (që nuk janë nëpunës civilë) të njësive të qeverisjes vendore caktohet nga këshilli përkatës, në kufirin maksimal deri në 20 000 (njëzet mijë) lekë.

17. Vendimi nr. 219, datë 13.4.2001 i Këshillit të Ministrave “Për shpërblimin e anëtarëve të këshillit të qarkut, të bashkisë, të njësive bashkiake të Tiranës, të komunave dhe të kryetarëve të fshatrave” shfuqizohet.

18. Vendimi nr. 726, datë 21.12.2000 i Këshillit të Ministrave “Për pagat e punonjësve të institucioneve buxhetore”, ndryshuar me vendimet përkatëse, si dhe çdo akt tjetër nënligjor, për punonjësit e organeve të qeverisjes vendore, që bie në kundërshtim me këtë vendim shfuqizohen.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 janar 2003.

KRYEMINISTRI

Fatos Nano

LIDHJA NR.1

NIVELET E PAGAVE PËR PUNONJËSIT CIVILË NË BASHKINË E TIRANËS

		Paga mujore (lekë)			
Klasa	Kategoria	Paga individuale			Shtesa e pozicionit
	1	2	3	4	5
		Paga e grupit	Shtesa për vjetërsi	Shtesa për kualifikim	Shtesa për pozicion
I	I – b	9000	2%	0	Nga 49 800 deri në 100 000

II	II – a	9000	2%	0	Nga 49 800 Deri në 90 000
	II – b	9000	2%	0	Nga 40 660 Deri në 74 000
III	III – a	9000	2%	0	Nga 13 000 Deri në 55 000
	III – b	9000	2%	0	Nga 12 000 Deri në 40 000
IV	IV – a	9000	2%	0	Nga 7000 Deri në 30 000
	IV – b	9000	2%	0	Nga 7 000 Deri në 20 000

LIDHJA NR.2
NIVELET E PAGAVE PËR NËPUNËSIT CIVILË NË BASHKITË E TJERA, NJËSITË
BASHKIAKE TË TIRANËS DHE NËPUNËSIT E KOMUNAVE

Paga mujore (lekë)								
Klasa	Kategoritë	Paga individuale			Shtesa e pozicionit sipas ndarjes së njësive vendore			
					Njësi të qeverisjes vendore me mbi 50001 banorë	Njësi të qeverisjes vendore me 20001- 50000 banorë	Njësi të qeverisjes vendore me 5001 – 20000 banorë	Njësi të qeverisjes vendore me më pak se 5000 banorë
	1	2	3	4	5	6	7	8
		Paga e grupit	Shtesa për vjetërsi	Shtesa për kualifikim	Shtesa për pozicion	Shtesa për pozicion	Shtesa për pozicion	Shtesa për pozicion
I	I – b	9000	2%	0	Nga 12000 deri 41000	Nga 11000 deri 31000	Nga 8000 deri 21000	Nga 6000 deri 17000
II	II – a	-	-	-	-	-	-	-
	II – b	9000	2%	0	Nga 9000 deri 31000	Nga 9000 deri 26000	Nga 6000 deri 20000	-
III	III – a	-	-	-	-	-	-	-
	III – b	9000	2%	0	Nga 9000 deri 26000	Nga 9000 deri 21000	Nga 6000 deri 16000	Nga 5000 deri 13000
IV	IV – a	9000	2%	0	Nga 3000 deri 16000	Nga 3000 deri 16000	Nga 2000 deri 14000	Nga 2000 deri 11000
	IV – b	9000	2%	0	Nga 3000 deri 13000	Nga 3000 deri 11000	-	-

Shënim: Këshilli i bashkisë dhe komunës, në përcaktimin e shtesës në pagë për pozicionin sipas ndarjes në njësi vendore, bazohet në numrin e banorëve të regjistrit të gjendjes civile në fillim të vitit kalendarik.

LIDHJA NR.3
NIVELET E PAGAVE PËR NËPUNËSIT CIVILË NË KËSHILLIN E QARKUT

Klasa	Kategoritë	Paga individuale			Shtesa e pozicionit
	1	2	3	4	5
		Paga e grupit	Shtesa për vjetërsi	Shtesa për kualifikim	Shtesa për pozicion
I	I – b	9000	2%	0	Nga 25000 deri 51000
II	II – a	-	-	-	-
	II – b	9000	2%	0	Nga 11000 deri 36000
III	III – a	-	-	-	-
	III – b	9000	2%	0	Nga 9000 deri 26000
IV	IV – a	9000	2%	0	Nga 3000 deri 18000

	IV – b	9000	2%	0	Nga 3000 deri 13000
--	--------	------	----	---	------------------------

LIDHJA 4

KLASIFIKIMI I VENDEVE TË PUNËS NË SHËRBIMIN CIVIL PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE

Vendet e punës në Shërbimin Civil grupohen në 4 klasa si më poshtë:

Klasa I: Ka përgjegjësinë për menaxhimin e institucionit, përcaktimin e programeve të përgjithshme në fushat që mbulon institucioni, koordinimin e këtyre programeve të përgjithshme dhe përdorimin eficient të të gjitha burimeve financiare, njerëzore etj., për arritjen e rezultateve të përcaktuara, si dhe dhënien e këshillimit përfundimtar dhe të drejtpërdrejtë drejtuesit të institucionit.

Në këtë klasë bëjnë pjesë kategoritë:

I – b. Sekretar i Përgjithshëm

Drejtor Departamenti

Klasa II: Është niveli më i lartë i menaxhimit të një institucioni dhe ka përgjegjësi për hartimin e programeve në fushën që mbulon dhe për arritjen e rezultateve të përcaktuara në këtë fushë.

Në këtë klasë bëjnë pjesë kategoritë:

II – a. Drejtor i Drejtorisë së Përgjithshme

Drejtor Drejtorie

Klasa III: Bën të mundur koordinimin e mendimeve dhe opsioneve të reja programore për një fushë të caktuar të specialitetit, zbatimin e programeve në këtë nivel, përgatitjen e propozimeve përfundimtare të cilat duhen aprovuar nga niveli menaxhues më i lartë. Kjo klasë bën të mundur gjithashtu edhe zgjidhjen e problemeve komplekse që lidhen me menaxhimin e projekteve të mëdha ose sektorëve/njësive brenda institucionit.

Në këtë klasë bëjnë pjesë kategoritë:

III - a Përgjegjës Sektori

Kryeinspektor

III - b Përgjegjës sektori

Specialist i nivelit të lartë

Inspektor

Klasa e IV: Kjo klasë merret me zbatimin e programeve ekzistuese, koordinimin e aktiviteteve të stafit mbështetës, si dhe me formulimin dhe vlerësimin e opsioneve mbi një fushë të caktuar, duke u bazuar në ekspertizën profesionale të fushës, njohuritë e specialitetit, analizën e informacionit dhe kërkimit.

Në këtë klasë bëjnë pjesë kategoritë:

IV - a Specialist i nivelit të mesëm

IV - b Specialist